



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 7**
nga mbledhja e mbajtur më **8.4.2008**
kryesuar nga **Zef Morina**-anëtarë i komisionit
Dëgjimi publik filloi në orën 14,00

Të pranishëm :

Elheme Hetemi, Berat Luzha, Zef Morina , Hesel Cakolli , Myrvete Pantina.

Munguan :

Kosara Nikolić, Selvie Halimi, Zylfi Merxha, Lulzim Zeneli, Ali Lajçi, Ibrahim Selmanaj.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku dhe Lule Ymeri.

Pjesëmarrësit tjerë : Ekspertët e ftuar

Dëgjimi publik rreth projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit

Zef Morina përshëndeti anëtarët e komisionit dhe ekspertët e ftuar të cilët i falënderoi për përgjigje në ftesë për kontribut. Ai shkurtimisht arsyetoi kërkesën e komisionit për këtë dëgjim publik, sidomos duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një ligj bazik mjedisor i cili do të zëvendësoi ligjin në fuqi nga viti 2003. Në fillim ai ju dha fjalën përfaqësuesve të MMPH për të deklaruar se kanë ndonjë ndryshim apo jo si propozues të ligjit.

Muhamet Aliu dhe Kadri Hyseni falënderuan për bashkëpunim dhe ftuan ekspertët

gjithashtu në bashkëpunim të frytshëm. Propozuan ndryshime në 2-3 nene të cilat propozim-ndryshime i dorëzuan me shkrim.

Zef Morina falënderoi dhe i luti të pranishmit mos të fokusohen në mënyrë eksplicite vetëm në ndryshime tekniko-formale të projektligjit, ngase në këtë dëgjim publik duhet të shqyrtohet arsyeshmëria e projektligjit se a meriton të bëhet ligj.

Zeqir Veselaj vërejtjet me shkrim i dorëzoi dhe apeloj tek deputetët që në nenin 52 të projekt kushtetutës të futet kapitulli për Mjedisin. Sa i përket projektligjit në fjalë ai sugjeroi për hera tjera të publikohen emrat e grupit punues që hartojnë një projektligj , ngase kemi të bëjmë me një transparencë të domosdoshme. Aktet nënligjore , vazhdoi ai, duhet ti lihen në kompetencë më tepër Ministrisë e jo Qeverisë, gjithashtu parimi i qasjes së publikut duhet të rregullohet me nene më konkretisht. Disa nene në këtë projekt përmendin ligjet e veçanta pa saktësuar për cilat është fjala, ngase tanimë Kuvendi i Kosovës ka mjaft ligje të miratuara. Në procedurën e VNM përmendet edhe leje mjedisore edhe pëlqim mjedisor, çka nuk lejohet një qasje e tillë, duhet të unifikohet fjalori profesional. Ky projektligj nuk saktëson qartë se Fondi a po themelohet apo po lejohet etj.

Në vazhdim **Agron Bektashi** dhe **Bedri Drini** paraqitën vërejtjet formale dhe premtuan se do ti dërgojnë edhe me shkrim.

Behxhet Mustafa shprehu brengosjen për tokat bujqësore të cilat nëse vazhdon kështu, do të asgjësohen në tërësi, ndaj patjetër duhet të harmonizohen qëndrimet komunale me ato qendrore. Ai përfundoi diskutimin dhe shprehu çudinë se si nuk organizohet një seancë plenare për tokat bujqësore të cilat duhet medoemos të mbrohen.

Baton Begolli ishte i mendimit se ligji në fuqi është më i mirë duke shtuar se me këtë projekt është munduar të plotësohet por në fakt është stërmadhuar dhe nuk ka fituar në kualitet. Shumë nene nuk kanë domethënie , ato ose duhet të hiqen ose të bashkohen. Gjohet duhet të jenë më koncize dhe më serioze sepse p.sh. çfarë paraqet për mjedisin shuma prej 5.000 euro deri 50.000 euro. Në vazhdim **Adem Nikqi** u ankua se nuk është bërë një ndarje e drejtë e kompetencave me këtë projekt, ndërsa **Fekrije Hasani** kërkoi që parimit të qasjes së publikut ti shtohet apo ndryshohet fjalia, duhet të jetë : “parimi i involvimit të publikut dhe qasja në informata dhe ngritjes së vetëdijes publike për mjedisin”, çka do të obligonte edukimin mjedisor duke përfshirë një lëndë obliguese mjedisore nëpër shkolla fillore.

Asllan Vitaku tha se ky ligj duhet të plotësohet me dispozitat që do të parashohin ngrohjen globale , sidomos mbrojtjen nga squfuri, karboni etj dhe afrimin me legjislacionin e BE të shtetit tonë. Sa i përket Fondit ai shtoi se prioriteti duhet të caktohet sa i përket riciklimit të mbeturinave nga të cilat mund të fitohet energjia e gjelbërt. **Ramadan Uka** bëri vërejtje se Qeveria shumë pak mirët me mirënjohje të cilat janë impuls për punë dhe masë stimuluese. Bordin Këshillues (neni 58) duhet hequr në tërësi. Sa i përket ndëshkimeve , ai bëri vërejtje sepse është treguar një zemërgjerësi për njerëz të pushtetit. Aktet ligjore do të nxirren në afat prej dy vitesh, ky afat është tepër i gjatë, përfundoi ai.

Në fund Zef Morina falënderoi pjesëmarrësit.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryesuesi i Dëgjimit Publik,
Zef Morina